



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25 Maj 2021

Nr: 368

V E N D I M

PËR

**SHPLLJEN E MOZGJEDHSHMËRISË SË KANDIDATIT TË RADHËS NË LISTËN SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALDEMOKRATE, QARKU SHKODËR, Z. GLEDIS ESAT ÇELIKU, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, dhe 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të Krerëve II, pika 3, dhe V të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës

VËREJ:

Me shkresën nr. 1084 prot., datë 04.05.2021, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Tom Gjek Doshi, i zgjedhur në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, propozuar nga Partia Socialdemokrate.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se, në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit të deputetit, kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Partia Socialdemokrate, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.68 , datë 20.03.2017.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 555, datë 26.07.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.06.2017 dhe miratoi listën shumemërore të deputetëve të zgjedhur për secilin subjekt në çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Socialdemokrate për zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Qershor 2017, ka fituar 1 (një) mandat dhe kandidati fitues nga lista shumemërore



Data: 25 Maj 2021

Nr. 368

Për shpalljen e mozgjedhshmërisë së kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialdemokrate, Qarku Shkodër, z. Gledis Esat Çeliku, për plotësimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë

e Partisë Socialdemokrate, Qarku Shkodër, është numri rendor 01 (një) z. Tom Gjek Doshi.

Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Socialdemokrate, Qarku Shkodër, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës.

Sipas listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, të Partisë Socialdemokrate, miratuar me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 290, datë 07.05.2017, rezulton se, kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 02 (dy), z. Gledis Esat Çeliku.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të pikës 3, të kreut II, të vendimit nr.17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, me shkresën nr. 5034 prot., datë 07.05.2021, i është drejtuar z. Gledis Esat Çeliku duke e njoftuar për depozitimin në KQZ të formularit të vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të kandidatit.

Referuar pikës 3, të Kreut II, të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit, afati i fundit për depozitimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të formularit të vetëdeklarimit ishte data 20.05.2021.

Brenda afatit të sipërcituar nuk është depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve formulari i vetëdeklarimit për garantimin e integritetit nga z. Gledis Esat Çeliku.

Referuar nenit 5, pika 2 të ligjit nr.138/2015, refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit përbën shkak për mosregjistrimin apo moszgjidhshmërinë e kandidatit si deputet i Kuvendit. Gjithashtu referuar Kreut II, pika 3 të vendimit nr.17/2016, të Kuvendit, nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim. Në këtë rast, organi kompetent ndërpret procedurën për propozimin e këtij subjekti për t’u kandiduar, zgjedhur apo emëruar në atë funksion publik.

Referuar nenit 11, pika 2 të ligjit nr.138/2015, konstatohet se kandidati i radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialdemokrate, Qarku Shkodër, nuk dorëzoi formularin e vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2 dhe 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në Krerët II, pika 3, dhe V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”



## V E N D O S:

1. Të shpall moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialdemokrate, Qarku Shkodër, z. Gledis Esat Çeliku.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Iirjan CELIBASHI**

Kopje: 3  
Afti i ruajtjes: 5 vjet  
Punoi:  
J.Dedaj \_\_\_\_\_  
B.Kodra \_\_\_\_\_  
M.Koja \_\_\_\_\_  
A.Lamçe \_\_\_\_\_  
Y.Merkaj \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2021

